



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Vojsava Zenelaj” pf
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta” kulla nr 2, kati 2 Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake

Referenca e procedures: Nr. REF-69154-08-19-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: Uniforma dhe veshje të tjera speciale për Policinë Bashkiake.

Fondi limit: 13,333,300 (trembëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind) **lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të VKB Nr 157 dt 26.12.2019 per "Miratimin e programit buxhetor afatmesem 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit te Bashkise Tirane per vitin 2020" (i ndryshuar).

Afati per realizimin e furnizimit: Operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 60 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.09.2020

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 59 datë 24 Gusht 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë -

1. Operatori ekonomik «Vojsava Zenelaj» pf

NUIS : L12330004A

Vlera e ofertes pa tvsh: **13.286.700 (trembëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind) lekë .**

Nuk është s’kualifikuar asnjë operator ekonomik

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "Vojsava Zenelaj" pf** me adresë: Bulevardi "Gjergj Fishta" kulla nr 2, kati 2 Tiranë se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **13.286.700 (trembëdhjetë milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind)** lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 23.09.2020.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.